**01 Nr. 02/21**
**Rahovec, 18.02.2021**

Ftohen anëtarët e Kuvendit Komunal, që të marrin pjesë në mbledhjen e cila do të mbahet më **26 shkurt 2021 (e premte)** me fillim në orën: **10:00**, në sallën e KK Rahovec.

Për këtë mbledhje propozoj këtë:

## R E N D D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve;
3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit për bartjen e të hyrave vetanake të vitit 2020,
4. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Taksa Komunale 01 Nr.80/20, e datës: 20.06.2020,
5. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit për shpalljen me interes te përgjithshëm publik pjesën e parcelës P – 71510057 – 01687-3 në zonën kadastrale Rahovec,
6. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit për lirim nga taksa komunale për bizneset që operojnë në komunën e Rahovecit,
7. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit për lirim nga qiraja mujore për bizneset dhe personat fizik të cilat shfrytëzojnë pronën e paluajtshme të Komunës,
8. Informatë për zonën e mbrojtur "Kanioni i Drinit të Bardhë tek Ura e Fshejtë"

**KRYESUESI I KUVENDIT**

**Afrim Dina**

**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**

**Kuvendi Komunal Rahovec/Skupština Opštine Orahovac/Municipal Assembly Rahovec**

**Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm**
**Odeljenje za Privredu, Razvoj i Turizam**
**Department of Economy, Development and Tourism**

| | |
|---|---|
| **DATË /A:** | **19.02.2021** |
| **PËR/ZA/TO :** | **z. Smajl Latifi**, Kryetar i Komunës së Rahovecit |
| **NGA/OD/FROM:** | **z. Artan Asllani**, Drejtor për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm |
| **LËNDA/SUBJEKAT/SUBJECT:** | **Propozim për falje të borxhit të Taksave Afariste Komunale për vitin 2021.** |

**I nderuar z. Kryetar!**

Duke e parë gjendjen aktuale të bizneseve të komunës së Rahovecit, si pasoj e vështirësive të të bërit biznes nga pandemia Covid-19 , Drejtoria për Ekonomi,Zhvillim dhe turizëm ka planifikuar dhe ju propozon që në seancën e mbledhjes së asamblesë komunale të muajit shkurt te propozojmë lirimin për vitin 2021 nga ngarkesa për Taksë Afariste Komunale për të gjitha biznesët në komunën e Rahovecit, gjithsejt janë **Kater qind e pedhjete kater (454)** biznese të ngarkuara me taksë afariste për vitin prej: **01.01. 2021 deri 31.12.2021**
**Vlera e faljes së borxhëve për vitin 2021 është 74.765,00 €.**

**Përjashtim nga falja e borxhit bëjnë këto biznese:**

1. **Bankat dhe institucionet mikrofinanciare**
2. **Kompanit e telekomit dhe posta**
3. **KEDS**
4. **Barnatoret shendetsore**
5. **Pompat e derivateve dhe**
6. **Kompanit e sigurimeve**

Po ashtu ne kemi planifikuar qe nese lirohen keto biznese te ju behet edhe propozimi qe te gjitha ato biznese qe kane borxhe në taksë afariste që janë perfitues i keti propozimi të i bejnë pagesat dhe obligimet e mbetura deri me 31.12.2021.

**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**

**Kuvendi Komunal Rahovec/Skupština Opštine Orahovac/Municipal Assembly Rahovec**

**Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm**
**Odeljenje za Privredu, Razvoj i Turizam**
**Department of Economy, Development and Tourism**

| | |
|---|---|
| **DATË /A:** | 19.02.2021 |
| **PËR/ZA/TO :** | z. Smajl Latifi, Kryetar i Komunës së Rahovecit |
| **NGA/OD/FROM:** | z. Artan Asllani, Drejtor për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm |
| **LËNDA/SUBJEKAT/SUBJECT:** | **Propozim për falje të borxhit të qerasë për vitin 2021.** |

**I nderuar z.Kryetar!**

Duke e parë gjendjen aktuale të shfrytëzuesve të pronës së paluajtshme të komunës së Rahovecit, si pasoj e vështirësive të të bërit biznes nga pandemia Covid-19 , Drejtoria për Ekonomi,Zhvillim dhe turizëm ka planifikuar dhe ju propozon qe në seancën e mbledhjes së asamblesë komunale të muajit shkurt te propozojm lirimin nga qiraja per te gjithe shfrytëzuesit e pronës së paluajtshme të komunës (rezervat shtetërore në fshatin Xërxe dhe lokalet afariste në Rahovec), gjithsejt janë tredhjetë e një (31) kontrata, vlera faljes së borxheve 50% për vitin 2021 është **41,428.68 €.**

Po ashtu ne kemi planifikuar qe nese lirohen keto biznese te ju behet edhe propozimi qe te gjitha ato biznese qe kane mbetje ne qira per me qene perfitues i keti propozimi te i bejn pagesat ne obligimet e mbetura deri me 31.12.2021.

## INFORMATË PËR ZONËN E MBROJTUR

### "Kanioni i Drinit të Bardhë te Ura e Fshejtë"

GJENDJA

Në zonën e mbrojtur të Kanionit të Drinit të Bardhë në të dy anët e sajë, si nga pjesa e Komunës së Gjakovës ashtu edhe nga ajo e Komunës së Rahovecit ka pasur ndërhyrje si në zonën e gjërë mbrojtëse ashtu edhe në atë të ngushtë- rigoroze.

- Në zonën nr.1, me sipërfaqe prej 15.42,72 ha, janë 6 objekte
  - 1- Restaurant Ura e Fshejtë (kontratë me Komunën e Rahovecit – 11.06.2013)
  - 5- Shtepiza malore në shërbim të rest aurantit (Kontratë me Komunën e Rahovecit – 13.07.2016)

- Në zonën nr.2 me sipërfaqe prej 51.63,89 ha, janë 9 objekte
  - 1- Kompleksi memorial "Obelisku"
  - 5- Objekte banimi- Shtëpi P+1
  - 3-Objekte garazhë në shërbim të shtëpisë

- Në zonën nr.3, me sipërfaqe prej 55.25,66 ha, janë 9 objekte
  - 1 - Betonjerkë / objekt në shërbim të betonjerkës – pëlqim nga Kuvendi.
  - 2 - Restaurante/ Kafe-Bar
  - 1 - Objekt (B+P+1) / Afarizem + Banim
  - 1 - Objekte banimi- Shtëpi P+1
  - 3 - Objekte industriale

Meqenese pronësia në masë të madhe ka kaluar nga ajo shoqërore në atë private atëherë edhe janë ndërtuar disa objekte banimi si dhe objekte tjera komerciale, fatkeqësisht pa marrjen e pëlqimit paraprak nga organi përgjegjës.

*Të bashkangjitur gjeni hartën me objekte të piketuara.*


Zk. Gradish
Në zonën nr.2
Me sipërfaqe prej 51.63,89 ha
Janë 9 objekte
1- Kompleksi memorial "Obelisku"
5- Objekte banimi Shtëpi P+1
3- Objekte garazh në shërbim të shtëpisë
Zona Nr. 2
S=51.63,89 ha
Zona Nr.
S=15.42
Në zonën nr.1
Me sipërfaqe prej 15.42,72 ha
Janë objekte
1- Restaurant- Ura e fshehtë
5- Shtëpiza malore në shërbim të restaurantit
Zk. X
Në zonën nr.3
Me sipërfaqe prej 55.25,66 ha
Janë 9 objekte
1- Betonjerkë
Objekt për nevoja të betonjerkës
2- Restaurante / Kafe-Bar
1- Objekt (B+P+1) -Afarizem + Banim
1- Objekt banimi Shtëpi P+1
1- Objekt për afarizëm
3- Objekte industriale

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Kuvendi i Komunës Rahovec***
*Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec*

Në bazë të nenit 12 pika 1 dhe 2 shkronja d), nenit 17, nenit 24 dhe nenit 40 paragrafi 2 shkronja c) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), dispozitave të Ligjit Nr. 07/L-041 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, dispozitave Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, Ligjit Nr. 05/L -108 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal dhe nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 39, nenit 40 paragrafi 2 pika 2.3, nenit 57 dhe nenit 65 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me dt. 26.02.2020 miraton këtë:

# VENDIM
## Për bartjen e mjeteve vetanake të pashpenzuara nga viti 2019 dhe 2020 në vitin 2021

1. **Miratohet** vendimi për bartjen e mjeteve vetanake të pashpenzuara nga viti 2019 dhe 2020 në vitin 2021 në shumën prej **506,707.39€ (peseqind e gjashtë mijë e shtatëqind e shtatë euro e tridhjetë e nëntë cent).**

2. Mjetet në shumën prej **506,707.39€ (peseqind e gjashtë mijë e shtatëqind e shtatë euro e tridhjetë e nëntë cent)** do të barten në vitin 2021 në këto programe dhe kategori buxhetore si në vijim:

- **Në kategorinë e pagave dhe mëditjeve:**
  - **a.** Në programin e Shëndetësisë dhe Mirëqenie Sociale (730), nën programi Shërbimet e shëndetësisë primare (737000), kodi funksional (0721) në shumën prej **21,926.00€.**

- **Në kategorinë e investimeve kapitale:**
  - **b. Në programin Shërbimet Publike (180), nën programi Infrastruktura Publike (18171), kodi funksional (0451).**
    - a) Ndërtimi i rrugëve në komunën e Rahovecit, kodi **40817** në shumën prej **17,000.00€;**
    - b) Ndërtimi i kanalizimeve në komunën e Rahovecit, kodi **48032** në shumën prej **45,000.00€;**
    - c) Investimet emergjente në infrastrukturë – vazhdim, kodi **40815** në shumën prej **50,000.00€;**
    - d) Trajtimi i kanalizimeve fekale (gropa septike) në komunën e Rahovecit, kodi **49862** në shumën prej **45,000.00€;**
    - e) Zgjerimi i ndriçimit publik në komunën e Rahovecit, kodi **49898** në shumën prej **20,000.00€;**
    - f) Mirëmbajtja e ndriçimit publik në komunën e Rahovecit, kodi **40814** në shumën prej **20,000.00€;**
    - g) Ndërtimi dhe trajtimi i ujërave atmosferik në qytet, kodi **49877** në shumën prej **40,000.00€;**
    - h) Ndërtimi i rrugëve në Hoçë të Vogël, Brestoc, Krushë e Madhe dhe Fortesë, kodi **40817** në shumën prej **20,000.00€.**

c. **Në programin Planifikimi urban dhe mjedis (660), nën programin planifikimi urban dhe inspeksion (66360), kodi funksional (0620).**
   a) Rregullimi i shtretërve të lumenjve dhe përroskave në komunën e Rahovecit, kodi **40840** në shumën prej **45,000.00€;**
   b) Ndërtimi i kullës prej guri për heronjtë – Opterushë, kodi **48064** në shumën prej **11,000.00€.**

d. **Në programin Bujqësia (470), nën programi Bujqësia (47011), kodi funksional (0421).**
   a) Ndërtimi i serrave me participim (80% - 20%) LOTO 1, kodi **46674** në shumën prej **40,000.00€;**
   b) Furnizim me komore ftohëse dhe laktofriz për qumësht me participim (80% - 20%), kodi **47832;40827** në shumën prej **40,000.00€.**

e. **Në programin Kulturë, Rini dhe Sport (850), nën programi Kulturë, Rini dhe Sport (85011), kodi funksional (0820).**
   a) Investime në infrastrukturën kulturore dhe kënde të lojërave për fëmijë, kodi **49947** në shumën prej **6,809.50€.**

f. **Në programin Arsim dhe Shkencë (920), nënprogramin Administrata (92055), kodi funksional (0980).**
   a) Ndërtimi i SHFMU "Heronjtë e Kosovës" në Hoqë të Vogël – Brestoc, kodi **46517** në shumën prej **11,000.00€;**
   b) Ndërtimi i Shkollës Fillore në Retijë, kodi **46534** në shumën prej **32,000.00€;**
   c) Ndërtimi i Çerdhes në Krushë të Madhe, kodi **48202** në shumën prej **48,000.00€;**
   d) Ndërtimi i Çerdhes në Xërxë, kodi **48206** në shumën prej **3,971.89€;**
   e) Riparimi në shkolla loto 2, kodi **40870** në shumën prej **20,000.00€.**

**3.** Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

**4.** Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL-në dhe 7 ditë pas shpalljes publike në ueb-faqen e Komunës së Rahovecit.

***Vendimi u dërgohet:***
- ***Kryetarit të Komunës,***
- ***Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,***
- ***MAPL-së, dhe***
- ***Arkivit.***

**KUVENDI I KOMUNËS SË RAHOVECIT**

**01 Nr. ___/2021**
**Datë: 26.02.2021**

**Afrim Dina**

________________

**Kryesues i Kuvendit**

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*KomunaRahovec*
*OpštinaOrahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Predsednik Opstine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 054 Nr. i faq/Br.str/No pg 170
Data/Datum/Date 09 / 02/ 2021
RAHOVEC / ORAHOVAC

Duke u bazuar në nenin 13 dhe nenin 58 shkronja h) të Ligjit Nr. 03/L040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), dispozitave të Ligjit Nr. 07/L-041 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, dispozitave Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, Ligjit Nr. 05/L -108 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, 74 paragrafi 1 dhe paragrafi 2 pika 2.9 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës Nr. 1005, i datës: 29.03.2017, Kryetari i Komunës:

**PROPOZON**

1. Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës së Rahovecit miratimin e vendimit me të cilin lejohet bartja e mjeteve vetanake të pa shpenzuara nga viti 2019 dhe 2020 në vitin 2021.

2. Mjetet e pa shpenzuara nga viti 2019 - 2020 janë në shumën prej **506,707.39€ (pesëqind e gjashtë mijë e shtatëqind e shtatë euro e tridhjetë e nëntë cent)**, këto mjete do të barten në vitin 2021 dhe do të shpërndahen në kategori ekonomike të caktuara si në vijim:

- **Në kategorinë e pagave dhe mëditjeve:**
  **2.1.**Në programin e Shëndetësisë dhe Mirëqenie Sociale (730), nën programi Shërbimet e shëndetësisë primare (737000), kodi funksional (0721) në shumën prej **21,926.00€.**

- **Në kategorinë e investimeve kapitale:**
  **2.2.Në programin Shërbimet Publike (180), nën programi Infrastruktura Publike (18171), kodi funksional (0451).**
  a) Ndërtimi i rrugëve në komunën e Rahovecit, kodi **40817** në shumën prej **17,000.00€;**
  b) Ndërtimi i kanalizimeve në komunën e Rahovecit, kodi **48032** në shumën prej **45,000.00€;**
  c) Investimet emergjente në infrastrukturë – Vazhdim, kodi **40815** në shumën prej **50,000.00€;**
  d) Trajtimi i kanalizimeve fekale (gropa septike) në Komunën e Rahovecit, kodi **49862** në shumën prej **45,000.00€;**
  e) Zgjerimi i ndriçimit publik në komunën e Rahovecit, kodi **49898** në shumën prej **20,000.00€;**
  f) Mirëmbajtja e ndriçimit publik në komunën e Rahovecit, kodi **40814** në shumën prej **20,000.00€;**
  g) Ndërtimi dhe trajtimi i ujërave atmosferik në qytet, kodi **49877** në shumën prej **40,000.00€;**
  h) Ndërtimi i rrugëve në Hoçë të Vogël, Brestoc, Krushë e Madhe dhe Fortesë, kodi **40817** në shumën prej **20,000.00€.**

**2.3.Në programin Planifikimi urban dhe mjedis (660), nën programin planifikimi urban dhe inspeksion (66360), kodi funksional (0620).**

a) Rregullimi i shtretërve të lumenjve dhe përroskave në komunën e Rahovecit, kodi **40840** në shumën prej **45,000.00€;**
b) Ndërtimi i kullës prej guri për heronjtë – Opterushë, kodi **48064** në shumën prej **11,000.00€.**

**2.4.Në programin Bujqësia (470), nën programi Bujqësia (47011), kodi funksional (0421).**

a) Ndërtimi i serrave me participim (80% - 20%) LOTO 1, kodi **46674** në shumën prej **40,000.00€;**
b) Furnizim me komore ftohëse dhe laktofriz për qumësht me participim (80% - 20%), kodi **47832;40827** në shumën prej **40,000.00€.**

**2.5.Në programin Kulturë, Rini dhe Sport (850), nën programi Kulturë, Rini dhe Sport (85011), kodi funksional (0820).**

a) Investime në infrastrukturën kulturore dhe kënde të lojërave për fëmijë, kodi **49947** në shumën prej **6,809.50€.**

**2.6.Në programin Arsim dhe Shkencë (920), nënprogramin Administrata (92055), kodi funksional (0980).**

a) Ndërtimi i SHFMU "Heronjtë e Kosovës" në Hoçë të Vogël – Brestoc, kodi **46517** në shumën prej **11,000.00€;**
b) Ndërtimi i Shkollës Fillore në Retijë, kodi **46534** në shumën prej **32,000.00€;**
c) Ndërtimi i Çerdhes në Krushë të Madhe, kodi **48202** në shumën prej **48,000.00€;**
d) Ndërtimi i Çerdhes në Xërxë, kodi **48206** në shumën prej **3,971.89€;**
e) Riparimi në shkolla loto 2, kodi **40870** në shumën prej **20,000.00€.**

3. Për zbatimin e këtij propozimi kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

4. Propozimi hyn në fuqi pas miratimit paraprak nga Kuvendi i Komunës.

***Me propozim të njoftohen:***

- ***Kryesuesi i Kuvendit të Komunës,***
- ***Sekretaria e Kuvendit,***
- ***Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe***
- ***Arkivi***

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY OF RAHOVEC
KRYETARI I KOMUNËS
RAHOVEC
ORAHOVAC

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Kuvendi i Komunës Rahovec*
*Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec*

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 1 dhe 2 shkronja d), nenit 17 shkronja g) dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), dhe nenit 2, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40 dhe nenit 57 paragrafi 1 pika 1.7 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me dt. 26.02.2021 miraton këtë:

# VENDIM

## Për lirim nga qiraja mujore për bizneset dhe personat fizik të cilat shfrytëzojnë pronën e paluajtshme të komunës (objekteve komunale dhe lokaleve afariste)

1. **Miratohet** propozimi i Kryetarit të Komunës Nr. 00/00/00 i datës: 00.00.2020 dhe merret vendimi që të **Lirohen** nga qiraja mujore bizneset dhe personat fizik që janë shfrytëzues të pronës së paluajtshme të Komunës (objekteve komunale dhe lokaleve afariste) në vlerën 50% (pesëdhjetë përqind), për periudhën 01.01.2021 deri më: 31.12.2021 në komunën e Rahovecit.

2. Lirimi nga qiraja mujore sipas pikës 1 të këtij vendimi bëhet për bizneset dhe personat fizik që janë shfrytëzues të pronës së paluajtshme të komunës, të cilët kanë kontratë për shfrytëzimin e objekteve komunale dhe lokaleve afariste që janë pronë e Komunës së Rahovecit.

3. Të gjitha bizneset dhe personat fizik që kanë kryer obligimet në raport me komunën për vitin 2020, lehtësimi do të ju bëhet në vitin 2021, ashtu siç është cekur në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi.

4. **Obligohen** shfrytëzuesit e objekteve komunale dhe lokaleve afariste të cekura në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi që obligimet e mbetura të qirasë për vitin 2021 ti kryejnë më së largu deri më datë: 31.12.2021.

5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm.

6. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Kryetarit të Komunës,***
- ***Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm,***
- ***MAPL-së, dhe***
- ***Arkivit.***

**KUVENDI I KOMUNËS SË RAHOVECIT**

**01-Nr.________**
**Datë: 26.02.2021**

**Afrim Dina**

**_______________**
**Kryesues i Kuvendit**

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***KomunaRahovec***
*OpštinaOrahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Predsednik Opstine – Municipal Mayor**

Duke u mbështetur në nenin 13 dhe nenin 58 shkronja (h) të Ligjit Nr. 03/L040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 74 paragrafi 2 pika 2.9 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës Nr. 1005, i datës: 29.03.2017, Kryetari i Komunës:

**P R O P O Z O N**

1. Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës së Rahovecit që të merret vendim që të lirohen nga qiraja mujore bizneset dhe personat fizik që janë shfrytëzues të pronës së paluajtshme të Komunës (objekteve komunale dhe lokaleve afariste) në vlerën 50% (pesëdhjetë përqind), për periudhën 01.01.2021 deri më 31.12.2021 në Komunën e Rahovecit.

2. Lirimi nga qiraja mujore sipas pikës 1 të këtij propozimi bëhet për bizneset dhe personat fizik që janë shfrytëzues të pronës së paluajtshme të komunës, të cilët kanë kontratë për shfrytëzimin e objekteve komunale dhe lokaleve afariste që janë pronë e Komunës së Rahovecit.

3. Të gjitha bizneset dhe personat fizik që kanë kryer obligimet në raport me komunën për vitin 2020, lehtësimi do të ju bëhet në vitin 2021, ashtu siç është cekur në pikën 1 dhe 2 të këtij propozimi.

4. **Obligohen** shfrytëzuesit e objekteve komunale dhe lokaleve afariste të cekura në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi që obligimet e mbetura të qirasë për vitin 2021 t'i kryejnë më së largu deri më datë: 31.12.2021.

5. Për zbatimin e këtij propozimi do të kujdeset Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm.

6. Propozimi hyn në fuqi pas miratimit paraprak nga Kuvendi i Komunës.

***Me propozim të njoftohen:***
- ***Kryesuesi i Kuvendit të Komunës,***
- ***Sekretaria e Kuvendit, dhe***
- ***Arkivi***

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 051 Nr. i faq/Br.str/No.pg 170
Data/Datum/Date 09/02/2021
RAHOVEC / ORAHOVAC

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Kuvendi i Komunës Rahovec*
*Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec*

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 1 dhe 2 shkronja d), nenit 17 shkronja g) dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), dhe nenit 2, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40 dhe nenit 57 paragrafi 1 pika 1.7 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me dt. 26.02.2021 miraton këtë :

## VENDIM
**Për lirim nga taksa komunale për bizneset që operojnë në komunën e Rahovecit**

1. **Lirohen** nga taksa komunale të gjitha bizneset të cilat operojnë në territorin e komunës së Rahovecit, të cilat janë të ngarkuara me Rregulloren për Taksa Komunale 01 Nr. 80/20 e datës: 29.06.2020 për periudhën nga data: 01.01.2021 deri me datë: 31.12.2021.

2. Përjashtimisht nga pika 1 e këtij vendimi nuk do të përfshihen këto biznese dhe persona fizik si më poshtë:
   **2.1** Bankat dhe Kompanitë financiare;
   **2.2** Kompanitë e Telekomit dhe Posta;
   **2.3** KEDS-i;
   **2.4** Barnatoret Shëndetësore;
   **2.5** Pompat e derivateve; dhe
   **2.6** Kompanitë e Sigurimit.

3. Të gjitha bizneset që kanë kryer obligimet në raport me komunën për vitin 2020, lehtësimi do t'iu bëhet në vitin 2021, ashtu siç është cekur në pikën 1 të këtij vendimi.

4. Obligohet Kryetari i Komunës, në bashkëveprim me dikasteret relevante, konform dispozitave ligjore në fuqi të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme për lirimin e bizneseve nga taksa komunale të cekur në pikën 1 të këtij vendimi.

5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm.

6. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

***Vendimi u dërgohet:***
- ***Kryetarit të Komunës,***
- ***Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm,***
- ***MAPL-së, dhe***
- ***Arkivit.***

**KUVENDI I KOMUNËS SË RAHOVECIT**

**01-Nr.________**
**Datë: 26.02.2021**

**Afrim Dina**

**Kryesues i Kuvendit**

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*KomunaRahovec*
*OpštinaOrahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Predsednik Opstine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 053 Nr. i faq/Br.str/No.pg 170
Data/Datum/Date 09/02/2021
RAHOVEC / ORAHOVAC

Duke u mbështetur në nenin 13 dhe nenin 58 shkronja (h) të Ligjit Nr. 03/L040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 74 paragrafi 2 pika 2.9 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës:

**PROPOZON**

1. Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës së Rahovecit që të merret vendim që të lirohen nga taksa komunale të gjitha bizneset të cilat operojnë në territorin e komunës së Rahovecit, të cilat janë të ngarkuara me Rregulloren për Taksa Komunale 01 Nr. 80/20 e datës: 29.06.2020 për periudhën nga data: 01.01.2021 deri më datë: 31.12.2021.

2. Përjashtimisht nga pika 1 e këtij propozimi nuk do të përfshihen këto biznese dhe persona fizik si më poshtë:
   - **2.1** Bankat dhe kompanitë financiare;
   - **2.2** Kompanitë e Telekomit dhe Posta;
   - **2.3** KEDS-i;
   - **2.4** Barnatoret Shëndetësore;
   - **2.5** Pompat e derivateve; dhe
   - **2.6** Kompanitë e Sigurimit.

3. Të gjitha bizneset dhe personat fizik që kanë kryer obligimet në raport me komunën për vitin 2020, lehtësimi do të ju bëhet në vitin 2021, ashtu siç është cekur në pikën 1 të këtij propozimi.

4. Obligohet Kryetari i Komunës, në bashkëveprim me dikasteret relevante, konform dispozitave ligjore në fuqi të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme për lirimin e bizneseve nga taksa komunale të cekur në pikën 1 të këtij propozimi.

5. Për zbatimin e këtij propozimi do të kujdeset Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm.

6. Propozimi hyn në fuqi pas miratimit paraprak nga Kuvendi i Komunës.

***Me propozim të njoftohen:***
- ***Kryesuesi i Kuvendit të Komunës,***
- ***Sekretaria e Kuvendit, dhe***
- ***Arkivi***

**Smajl Latifi**
**Kryetari i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY OF RAHOVEC
KRYETARI I KOMUNËS
RAHOVEC ORAHOVAC

Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 shkronja d), nenit 17 dhe nenit 40 pika 2 shkronja (a) dhe (d) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 12, nenit 40 paragrafi 2 pika 2.1 dhe nenit 57 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Propozimit të Kryetarit të Komunës me Nr. _________ të dt. 00.00.2021, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me dt. 26.02.2021 miraton këtë:

**RREGULLORE**
**Për**
**Ndryshimin dhe Plotsimin e Rregullores për Taksa Komunale 01 Nr. 80/20 e datës 29.06.2020**

1. Kuvendi i Komunës së Rahovecit **miraton** Rregulloren për ndryshimin dhe plotësimin Rregullores për Taksa Komunale 01 Nr. 80/20 të datës: 29.06.2020.

2. Nenit 30 të Rregullores së cekur në pikën 1 i shtohet paragrafi 7 me tekstin si në vijim:

   **30.7.** Të gjitha bashkësitë fetare që operojnë në Komunën e Rahovecit lirohen nga pagesa e taksës komunale mbi parkimin e automjeteve të parapara në paragrafin 3 të këtij neni.

3. Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Rahovecit, ndryshimi dhe plotësimi i Rregullores për Taksa Komunale do të jetë pjesë e tekstit bazë të Rregullores në fuqi.

4. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky ndryshimi dhe plotësimi i Rregullores për Taksa Komunale hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

***Të njoftohen:***
- ***Kryetari i Komunës,***
- ***Drejtorët e Drejtorive,***
- ***MAPL, dhe***
- ***Arkivi.***

**KUVENDI I KOMUNËS SË RAHOVECIT**

**01-Nr.________**
**Datë: 26.02.2021**

**Afrim Dina**
______________
**Kryesues i Kuvendit**

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Komuna e Rahovecit***
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

---

Nr.Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr. 052 Nr. i faq/Br.str/No.pg 170
Data/Datum/Date 09/02/2021

Në bazë të nenit 11, nenit 13 dhe nenit 58 shkronja h) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr.28/2008"), nenit 12, nenit 74 paragrafi 2 pika 2.9 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës:

**P R O P O Z O N**
**Ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Taksa Komunale 01 Nr. 80/20, e datës: 29.06.2020**

1. Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës së Rahovecit ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Taksa Komunale 01 Nr. 80/20 e datës: 29.06.2020.

2. Nenit 30 të Rregullores së cekur në pikën 1 të këtij propozimi i shtohet paragrafi 7 me tekstin si në vijim:

   **30.7.** Të gjitha bashkësitë fetare që operojnë në territorin e komunës së Rahovecit lirohen nga pagesa e taksës komunale mbi parkimin e automjeteve të parapara në paragrafin 3 të këtij neni.

3. Propozimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***U dërgohet:***

- ***Kryesuesit të Kuvendit,***
- ***Sekretarisë së Kuvendit, dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Kuvendi i Komunës Rahovec*
*Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec*

Në mbështetje të nenit 12 pika 1 dhe pika 2 shkronja d), nenit 14 pika 1, nenit 17 shkronja (c) dhe nenit 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 2, nenit 4, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40 paragrafi 2 pika 2.11, nenit 57 paragrafi 1 pika 1.3 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, propozimit të Kryetarit të Komunës me Nr. Protokolli 00/00/00 të dt. 00.00.2020, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me dt. 26.02.2021 miraton këtë:

**VENDIM**
**Shpalljen me interesi të përgjithshëm publik pjesën e parcelës P-71510057-01687-3 në Zonën Kadastrale Rahovec**

1. **Miratohet** propozimi i Kryetarit te Komunës Nr. 00/00/00 i dt. 00.00.2020 dhe shpallet interes i përgjithshëm publik pjesa e parcelës kadastrale **P-71510057-01687-3** në Zonën Kadastrale Rahovec, në sipërfaqe prej $81m^2$ (tetëdhjetë e një metra katror) nga sipërfaqja e përgjithshme prej $319m^2$ (treqind e nëntëmbëdhjetë metra katror) në vendin e quajtur Strana, e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të N.T.P. AGRONOMI.

2. Qëllimi i shpalljes së interesit të përgjithshëm publik të pjesës së parcelës të cekur në pikën 1 të këtij vendimi do të jetë "Hapja e rrugës publike" në Rahovec, e cila do të shërbejë për lëvizjen e lirë të qytetarëve të komunës së Rahovecit dhe më gjerë.

3. Autorizohet Kryetari i Komunës që komform dispozitave ligjore në fuqi të ndërmerr të gjitha veprime të nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

4. Bartës për rregullimin e dokumentacionit teknik dhe regjistrimin e pronës në Librin Kadastral do të jetë Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Rahovecit.

5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.

6. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Anëtarëve të Kuvendit,***
- ***Shërbimit të Kuvendit,***
- ***MAPL-së, dhe***
- ***Arkivit.***

**KUVENDI I KOMUNËS SË RAHOVECIT**

**Nr. __________**
**Datë: 26.02.2021**

**Afrim Dina**

**Kryesues i Kuvendit**

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Komuna e Rahovecit***
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

---

Në mbështetje të nenit 13, nenit 14.1, nenit 17 dhe nenit 58 shkronja (h) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28/2008"), nenit 74 paragrafi 2 pika 2.9 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës: 29.03.2017, Kryetari i Komunës, Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës së Rahovecit i:

**PROPOZON**
**Shpalljen me interes të përgjithshëm publik pjesën e parcelës P-71510057-01687-3 në Zonën Kadastrale Rahovec**

1. Kryetari i Komunës, Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës së Rahovecit i propozon inicimin e procedurës për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik pjesën e parcelës **P-71510057-01687-3** në Zonën Kadastrale Rahovec, në sipërfaqe prej $81m^2$ (tetëdhjetë e një metra katror) nga sipërfaqja e përgjithshme prej $319m^2$ (treqind e nëntëmbëdhjetë metra katror) në vendin e quajtur Strana, e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të N.T.P. AGRONOMI.

2. Qëllimi i shpalljes së interesit të përgjithshëm publik të pjesës së parcelës të cekur në pikën 1 të këtij propozimi do të jetë "Hapja e rrugës publike" në Rahovec, e cila do të shërbejë për lëvizjen e lirë të qytetarëve të komunës së Rahovecit dhe më gjerë.

3. Bartës për rregullimin e dokumentacionit teknik dhe regjistrimin e pronave në Librin kadastral do të jetë Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Rahovecit.

4. Për zbatimin e këtij Propozimi do të kujdeset Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.

5. Ky propozim hyn në fuqi pas miratimit paraprak nga Kuvendi i Komunës.

***Të njoftohen:***

- ***Kryesuesi i Kuvendit të Komunës,***
- ***Sekretaria e Kuvendit,***
- ***Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, dhe***
- ***Arkivi.***

KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 050 Nr. i faq/Br.str/No.pg 1+0
Data/Datum/Date 09 / 02 / 2021
RAHOVEC / ORAHOVAC

Smajl Latifi
Kryetari i Komunës

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT / KRYETARI I KOMUNËS
RAHOVEC ORAHOVAC

KOMUNËS SË RAHOVECIT

DREJTORISË PËR GJEODEZI, KADASTËR DHE PRONË

AVOKAT-ADVOKAT
QAZIM ... QESKA
TEL 044/502 883
RAHOVEC-ORAHOVAC

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
... të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu
-III- Nr. i prot / Br. prot. 73 Më / Dt. 13.01.2021
RAHOVEC - ORAHOVAC

**LËNDË: N.T.P. „Agronomi "me pronar Gëzim Rexhep Cena nga Rahoveci.**

**KËRKESË**
**PËR KËMBIMIN E PRONËS SË PALUAJTSHME**

I nderuar zotëri kryetar unë Gëzim Rexhep Cena nga Rahoveci, jam themelues dhe menaxher i subjektit afarist N.T.P. „Agronomi ", me seli në Rahovec, i cili subjekt është pronar i paluajtshmërisë që evidentohet si parcelë kadastrale nr.1687-3, në vendin e ashtuquajtur "Strana", në sipërfaqe prej 319 m², ZK Rahovec, pikërisht lokacioni i kësaj parcele është në qytetin e Rahovecit, në afërsi të shkollës fillore "Isa Boletini "në Rahovec.

Këtë paluajtshmëri unë dhe subjekti i im afarist, e kam pronë legale dhe legjitime të fituar me punë të ligjshme juridike.

**Provë:**Çertifikata e pronës e datës 12.01.2021.

Një pjesë e kësaj parcele e cila është pronë e imja dhe e subjektit tim afarist në vend të ngjarjes shfrytëzohet si rrugë të cilën e përdorin qytetarët që gravitojnë në këtë zonë, dhe sipërfaqja e shfrytëzuar si rrugë për kalim për qytetarët që gravitojnë në këtë zonë është prej 44 m².

**Provë:**Shiqimi në vend me gjeometër.

Unë Gëzim Rexhep Cena jam pronar legal dhe legjitim i paluajtshmërisë që evidentohet si parcelë kadastrale nr.1687-1, të të njëjtin vend e cila parcelë kufizohet me pronën shtetërore titullar Komuna e Rahovecit si parcelë kadastrale nr.1355-4 ZK Rahovec, pjesën të parcelës të cilën unë pasi që është në kufijtë me parcelën time me qëllim të shfrytëzimit dhe mbrojtjes të paluajtshmërisë time e kam rrethuar me rrethoja të përkohshme, vetëm për qëllime personale dhe shfrytëzimit të parcelës sime në mënyrë më racionale.

**Provë:**Çertifikta e pronës për parcelën pronë shoqëroe KK.Rahovec nr.1355-4, dhe parcelën nr.1687-1.

Meqenëse pjesa e parcelës sime nr.1687-3, në sipërfaqe rreth 44 m²,shfrytëzohet si rrugë për kalim nga ana e qytetarëve të kësaj lagjeje, përkundër faktit se më paraqet probleme për mua si pronar, jam i gatshëm që këtë pjesë pas matjeve detale në terren ta liroj për interes të përgjithshëm dhe e njëjta të këmbehet konform rregullave në fuqi me pjesën e parcelës nr.1355-4 që është pronë shoqërore e Kosovës titullar Komuna e

Rahovecit, pasi që e njëjta ndodhet në kufi me parcelën time nr.1687-1, dhe është e rrethuar në tërësi me rrethoja të përkohshme.

Andaj të nderuar zotërinj pasi që unë jam i gatshëm që pjesën e parcelës sime nr.1687-3, ta liroj për interes të përgjithshëm si rrugë, kërkoj në këmbim pjesën e parcelës nr. 1355-4, që është pronë e komunës, këmbim ky që do të bëhet pas vlerësimit real të komisionit tuaj përkatës dhe matjeve gjeodezike të terren.

Lidhur me kërkesën time për këmbim të pronës private me ate komunale unë jam i gatshëm të bashkëpunoj në çdo kohë për vendosje të drejtë dhe të ligjshme në interes të përgjithshëm pa asnjë dëmtim të njërës apo palës tjetër.

Duke pritur që kërkesa ime për këmbim të shqyrtohet dhe të vendoset konform dispozitave të ligjit për këmbim të pronës shtetërore, do të jem në dispozicionin tuaj bashkëpunues deri në vendosje sipas propozimit përkatës të organeve kompetente.

**Rahovec, 12.01.2021.**

**Për N.T.P. „Agronomi "pronar :**

**Gëzim Rexhep Cena nga Rahoveci**
**nr.kontakt 044-226-367.**

<u>Shtojcë</u>: Skica e terrenit,
tri çertifikatat të pronës,
çertifikata e regjistrimit në ARBK.

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

MINISTRIA E EKONOMISË DHE AMBIENTIT / MINISTARSTVO EKONOMIJE I ŽIVOTNE SREDINE / MINISTRY OF ECONOMY AND ENVIRONMENT
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

# CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

## NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-71510057-01687-3

| | |
|---|---|
| **Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:** | 08-942-03-0000370/21 |
| **Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:** | 12.01.2021 - 11:01 |
| **Komuna / Opština / Municipality:** | Rahovec / Orahovac / Rahovec |
| **Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:** | RAHOVEC / ORAHOVAC / RAHOVEC |
| **Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:** | Rahovec / Orahovac / Rahovec |

## A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

| Numri i njësisë kadastrale<br>Broj katastarske jedinice<br>Cad. Unit. No. | Lloji i njësisë<br>Vrsta Jedinice<br>Unit Type | Lloji i pronës<br>Vrsta imovine<br>Property Type | Zona<br>U/R<br>G/S<br>U/R | Sipërfaqja<br>Površina<br>Area<br>(m²) | Përshkrim<br>Opis<br>Description | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| P-71510057-01687-3 | PARCELË / PARCELA / PARCEL | Pronë private / Privatna Imovina / Privatelly owned Land | Urban | 319 | | | |

## A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE /CADASTRAL UNIT ADDRESS

| Vendbanimi - adresa<br>Prebivaliste - adresa<br>Resident - address | Kodi Postal<br>Poštanski Kod<br>Postal Code | Hollësitë e adresës<br>Pojedinosti adrese<br>Address Details | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|
| STRANA-STRANA/STRANA-STRANA/STRANA-STRANA | | STRANA-STRANA | | |

Printuar nga / Odštampani od / Printed by: Nazmi Krasniqi |P-71510057-01687-3 |

Zyrtari përgjegjës / Odgovorno lice / Official person

## A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

| Numri<br>Broj<br>Number | Lloji i shfrytëzimit të parcelës<br>Vrsta koriscenja parcele<br>Parcel Type Of Use | Shfrytëzimi aktual i parcelës<br>Trenutno koriscenje parcele<br>Parcel Current Use | Kualiteti i klasës<br>Kvalitet klase<br>Quality Class | Sipërfaqja (m²)<br>Površina (m²)<br>Area (m²) |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Tokë Tjetër/Ostalo Zemljiste/OtherLand | Jo Pjellore/Neplodno/Unproductive | | 319 |

## B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

| Të drejtat<br>Prava<br>Rights | Emri<br>Ime<br>Name | Nr. personal<br>Licni broj<br>ID. No. | Vendbanimi<br>Prebivaliste<br>Resident | Kodi postal<br>Poštanski kod<br>Postal code | Hollësitë e adresës<br>Pojedinosti adrese<br>Address details | Pjesa e pronës<br>Deo Imovine<br>Share quota | Pershkrimi<br>Opis<br>Description | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Posedim individual /<br>Individualna Drzavina /<br>single possessor | N.T.P. AGRONOMI | 80422571 | RAHOVEC /<br>ORAHOVAC /<br>RAHOVEC / | | | 1/1 | kont.shit.lrp.nr.3726/14<br>date12.12.2014 | 19.01.2015 |

# SKICE TERENI

**Z.K Rahovec** **Shk.zv. 1:500**




**Data: 04.02.2021**

Kompania Gjeodete
N.Sh. Geo Line